POSTIM ARKIVOR

Koçi Xoxe dhe operacioni i Shkodrës në dokumentet e procesit penal



SEKSIONI

Kufiri Shkoder

PERIUDHA

1944 - 1944

Pas vendosjes së regjimit komunist në nëntor 1944, Shkodra u bë një nga zonat ku represioni politik mori përmasa veçanërisht të ashpra, duke u shoqëruar me arrestime, hetime, gjykime, ekzekutime dhe ndjekje të vazhdueshme të kundërshtarëve politikë dhe grupeve të konsideruara kundërshtare nga regjimi. Në periudha të ndryshme, represioni u shtri edhe ndaj klerit, familjeve dhe personave të dyshuar për veprimtari kundër regjimit, si dhe ndaj atyre që tentonin të kalonin kufirin. Në vitet e para të regjimit, represioni u shoqërua me operacione të gjera në Kelmend dhe me goditjen e rezistencës së armatosur në Postribë. Gjatë viteve 1945–1948, dokumentacioni i kohës evidenton një numër të madh grupesh dhe individësh të konsideruar nga autoritetet si kundërshtarë të regjimit. Një pjesë e tyre u arrestuan, u dënuan me burgim ose me vdekje, ndërsa raste të tjera lidhen me vrasje gjatë përpjekjeve për arratisje ose në kufi.

Kuadri ligjor dhe procedural: Ese pershkrese - “Trajtimi i personave të ekzekutuar dhe të atyre që vdiqën në duart e shtetit: 1944–1960 – Kuadri normativ, tipologjia dhe zinxhiri procedural”, S.Mara, O.Besho, L.Ismaili & J.Hibo,, AIDSSH.

Gjatë viteve të para të regjimit komunist, trajtimi i personave të akuzuar për veprimtari kundër pushtetit u mbështet në një kuadër të posaçëm ligjor, i cili përcaktonte kompetencat e gjykatave, veprat penale, masat e dënimit dhe procedurat për shqyrtimin e vendimeve, përfshirë dënimin me vdekje. Një nga aktet e para ishte Ligji nr. 21, datë 15.12.1944, “Mbi sabotatorët e Luftës dhe të pushtetit të popullit” , i miratuar menjëherë pas vendosjes së pushtetit të ri. Ky ligj krijoi një nga bazat e para normative për ndjekjen dhe dënimin e personave të konsideruar nga autoritetet si kundërshtarë ose sabotatorë të pushtetit. Më pas, Ligji nr. 41, datë 23.01.1945, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake” , përcaktoi organizimin, kompetencat dhe funksionimin e gjykatave ushtarake. Ligji u botua në Fletoren Zyrtare nr. 3 bis dhe u përdor si bazë ligjore edhe për proceset e zhvilluara në vitet e para të regjimit. Dispozitat e tij përcaktonin procedurat e gjykimit dhe parashikonin edhe dënimin me vdekje. Në vendimet gjyqësore të kësaj periudhe, referimi te nenet përkatëse të Ligjit nr. 41 shfaqet si pjesë e bazës ligjore mbi të cilën mbështetej vendimi. Një element i rëndësishëm i këtij kuadri ishte edhe parashikimi i shkaqeve lehtësuese . Neni 16 i Ligjit nr. 41/1945 parashikonte mundësinë e zbutjes së dënimit për persona që dorëzoheshin brenda afatit të përcaktuar në shpalljet përkatëse. Dokumentacioni gjyqësor dëshmon se kjo dispozitë zbatohej konkretisht në vendimmarrje dhe mund të ndikonte në masën e dënimit edhe në rastet kur prokuroria kishte kërkuar një dënim më të rëndë. Në dhjetor 1946 hyri në fuqi Ligji nr. 372, “Mbi fajet kundra popullit dhe shtetit” , i cili zgjeroi kuadrin penal për ndjekjen e veprave të konsideruara kundër pushtetit dhe shtetit. Në vendimet e viteve 1947–1949, ky ligj citohet së bashku me dispozita të tjera të legjislacionit penal dhe procedural. Ndër nenet e referuara në dokumentacion janë dispozitat që lidhen me humbjen e të drejtave civile e politike, bashkimin e dënimeve dhe masat e dënimit. Krahas legjislacionit të posaçëm, në procedurat gjyqësore zbatoheshin edhe Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale . Dokumentet evidentojnë, ndër të tjera, përdorimin e dispozitave për humbjen e të drejtave civile dhe politike, bashkimin e dënimeve dhe procedurën e detyrueshme të përcjelljes së vendimeve që përmbanin dënim me vdekje në instancat më të larta. Në këtë kuadër, neni 302 i Kodit të Procedurës Penale parashikonte dërgimin e vendimit përkatës në instancën më të lartë kur ai përmbante dënim kapital.

Procedura për dënimin me vdekje

Dokumentet gjyqësore tregojnë se dënimi me vdekje nuk përfundonte me shpalljen e vendimit nga gjykata që shqyrtonte çështjen. Vendimet për dënim kapital përcilleshin për shqyrtim dhe miratim në instancat më të larta. Një shembull i dokumentuar është procedura e ndjekur nga Gjykata Ushtarake e Shkodrës në dhjetor 1946 . Pas zhvillimit të procesit dhe shpalljes së vendimit nr. 662, më 16 dhjetor 1946, gjykata i përcolli Gjykatës së Naltë Ushtarake dosjet që përmbanin vendimet me vdekje, duke kërkuar miratimin e tyre. Dokumentacioni tregon se gjykata mund të propozonte edhe ndryshimin ose mosmiratimin e një dënimi, duke paraqitur arsyet përkatëse. Më 26 dhjetor 1946 , Gjykata e Naltë Ushtarake dha përgjigje me radiogram, duke miratuar dënimin me vdekje për disa prej të dënuarve, ndërsa për të tjerë vendosi ndryshimin ose zbutjen e dënimit. Një radiogram i dytë, më 18 janar 1947 , përcaktoi më tej ndryshimin e një prej dënimeve në burgim të përjetshëm. Dokumentet e kësaj procedure përmbajnë edhe një kërkesë të përsëritur për njoftimin e “datës së ekzekutimit dhe vullnetit të tyre të fundit” . Kjo tregon se, pas miratimit të dënimit, ekzekutimi dhe të dhënat që lidhen me të përbënin pjesë të një procedure administrative të përcaktuar. Organet përgjegjëse për zbatimin Dokumentacioni evidenton gjithashtu ndarjen ndërmjet organit që jepte vendimin dhe organit që ngarkohej me zbatimin e tij. Në dokumentet e mëvonshme, vendimi gjyqësor i përcillej Degës së Punëve të Mbrendshme, Seksionit të Ndjekjes së Krimeve , si organ përgjegjës për zbatimin e dënimit. Kjo ndarje institucionale është e rëndësishme për leximin e dokumentacionit arkivor, pasi dosja gjyqësore mund të dokumentojë vendimin, miratimin dhe dërgimin për ekzekutim, ndërsa dokumentet që lidhen me kryerjen faktike të ekzekutimit duhet të kërkohen edhe në fondet e organeve zbatuese. Dokumentimi i ekzekutimit dhe i trupit Në dosjet gjyqësore të shqyrtuara, dokumentacioni mbi dënimin me vdekje dhe miratimin e tij është më i plotë sesa dokumentacioni mbi ekzekutimin faktik, datën e tij, vendin dhe trajtimin e trupit. Për këtë aspekt janë të rëndësishme rregulloret e brendshme të institucioneve të vuajtjes së dënimit, të cilat ofrojnë dëshmi mbi praktikën administrative. Rregullorja nr. prot. 01-68, datë 16.10.1965 , në nenin 149, përcaktonte se kufoma e personit të pushkatuar, të vdekur nga aksidenti ose nga sëmundja nuk lejohej t'u dorëzohej familjarëve ose të afërmve, përveç rasteve kur, pas vdekjes, organet e drejtësisë e deklaronin personin të pafajshëm. E njëjta rregullore parashikonte edhe ekzistencën e dokumentacionit të posaçëm për ekzekutimin. Ajo përcaktonte se procesverbali i kontrollit mjekësor të të vrarit dhe procesverbali i mbajtur në vendin e ekzekutimit ruheshin për një periudhë të caktuar dhe më pas asgjësoheshin. Sipas dispozitës përkatëse, këto dokumente qëndronin pa u asgjësuar për tre vjet nga data e ekzekutimit. Këto rregulla janë të rëndësishme për kuptimin e boshllëqeve në dokumentacionin arkivor. Ato dëshmojnë se ekzekutimi shoqërohej nga dokumente administrative dhe mjekësore, por se ruajtja e tyre nuk ishte e pakufizuar në kohë. Për pasojë, mungesa e këtyre dokumenteve në dosjet gjyqësore nuk nënkupton domosdoshmërisht se dokumentacioni nuk ishte krijuar. Duhet theksuar se rregulloret e viteve 1965 dhe 1977 janë më të vona se periudha 1944–1960 . Për këtë arsye, ato nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë për çdo rast të viteve të para të regjimit, por si dëshmi normative dhe administrative për mënyrën e rregullimit të dokumentimit dhe trajtimit të personave të ekzekutuar në periudhat pasuese. Në tërësi, dokumentacioni i shqyrtuar evidenton një zinxhir të përcaktuar institucional: hetimi dhe gjykimi → shpallja e dënimit → përcjellja për miratim → miratimi ose ndryshimi i dënimit → dërgimi te organi zbatues → ekzekutimi dhe dokumentimi i tij . Për rastet kur dokumenti i fundit i këtij zinxhiri nuk gjendet në dosjen gjyqësore, kërkimi duhet të shtrihet te fondet e organeve që kishin kompetencën për zbatimin e dënimit dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.

PERMBAJTJE #3

Shkodra dhe kufiri: Represioni, ekzekutimet dhe personat e zhdukur- Material i përgatitur nga B. Buci, AIDSSH.

Pas vendosjes së regjimit komunist në nëntor 1944, Shkodra u bë një nga zonat ku represioni politik mori përmasa veçanërisht të ashpra, duke përfshirë arrestime, hetime, gjykime, ekzekutime dhe ndjekje të vazhdueshme të kundërshtarëve politikë, klerit, familjeve dhe personave që tentonin të kalonin kufirin. Në vitet e para të regjimit, represioni u shoqërua me operacione të gjera në Kelmend dhe me goditjen e rezistencës së armatosur në Postribë. Gjatë viteve 1945–1948, dokumentacioni evidenton raste të shumta arrestimesh, dënimesh me burgim e vdekjeje, si dhe vrasjesh gjatë përpjekjeve për arratisje ose në kufi. Materiali në vijim përmbledh zhvillimet kryesore të represionit politik në Shkodër gjatë diktaturës komuniste, bazuar në dokumentacion arkivor . Për përgatitjen e tij janë marrë si burim arkivor “Historiku i Sigurimit të Shtetit për Shkodrën” nga arkivi i Sigurimit të Shtetit të AIDSSH si dhe bazuar tek libri i At Zef Pllumit, “Rrno vetëm për me tregue” , të cilat pasqyrojnë arrestimet, hetimet, gjykimet, ekzekutimet dhe format e tjera të përndjekjes.

PERMBAJTJE #4

Shkodra dhe kufiri: Represioni, ekzekutimet dhe personat e zh-dukur

1. HYRJA E FORCAVE KOMUNISTE NË SHKODËR, 28 NËNTOR 1944, ARRESTIMET DHE SPASTRIMET NDAJ KUNDËRSHTARËVE Më 28–29 nëntor 1944, pas tërheqjes së forcave gjermane, forcat komuniste hynë në Shkodër. Në vijim nisën arrestimet dhe masat represive ndaj kundërshtarëve politikë. Në fillim të janarit 1945 u arrestuan rreth 150 persona , ndërsa më 28 janar, në kuadër të “Gjendjes së Jashtëzakonshme”, u arrestuan 120 persona nga një listë prej 250 vetësh. 2. OPERACIONI PËR SHTYPJEN E “KRYENGRITJES SË KELMENDIT” (JANAR–SHKURT 1945) Në janar–shkurt 1945 u zhvillua një operacion i gjerë ushtarak kundër rezistencës në Kelmend dhe në zona të tjera të veriut. Pas përplasjes së 15 janarit në Urën e Tamarës, operacioni në shkallë të gjerë nisi më 28 janar dhe përfundoi me rrethimin e forcave të Preng Calit në Vukël më 17 shkurt. Sipas dokumentit, u vranë 44 kryengritës , u kapën 18 krerë , ndërsa u raportuan 7 të vrarë nga forcat partizane . 3. KRYENGRITJA E POSTRIBËS, 9 SHTATOR 1946 Kryengritja e Postribës shpërtheu më 9 shtator 1946 dhe u drejtua nga Jup Kazazi. Rreth 450 kryengritës morën Koplikun dhe rrethuan Shkodrën. Sipas dokumentit, 33 kryengritës u vranë , 8 u kapën dhe u vranë pa gjyq , ndërsa rreth 200 u gjykuan dhe u dënuan . Për periudhën 1945–1948 përmenden rreth 26 grupe rezistence , me rreth 738 persona , nga të cilët 608 konsiderohen të asgjësuar sipas dokumentacionit. 4. PROCESET GJYQËSORE – DËNIMET ME EKZEKUTIM NDAJ KLERIT KATOLIK Represioni ndaj klerit katolik u shoqërua me procese gjyqësore ndaj klerikëve, intelektualëve dhe kundërshtarëve politikë. Në gjyqin e zhvilluar në janar 1946, 8 persona u dënuan me pushkatim , ndërsa në procesin e janarit 1948, nga 12 të akuzuar, u dënuan me vdekje dhe u pushkatuan Frano Gjini, Mati Prenushi dhe Nikoll Deda . 5. PROCESET GJYQËSORE VIJUESE KUNDËR GRUPEVE PËR PËRMBYSJEN E PUSHTETIT POPULLOR Në vitet pas vendosjes së regjimit, ndjekja politike në Shkodër vijoi përmes hetimit dhe goditjes së grupeve të konsideruara nga autoritetet si “armiqësore”. Dokumenti përmend grupe gjimnazistësh, të rinjsh, klerikësh, intelektualësh, ushtarakësh, punonjësish të Sigurimit dhe persona të akuzuar për lidhje me organizata apo shërbime të huaja. Ndjekja përfshinte akuza për agjitacion e propagandë, tentativë arratisjeje, shpërndarje traktesh, veprimtari fetare dhe pjesëmarrje në organizata kundërshtare.


Koçi Xoxe

Koçi Xoxe (1911–1949) ishte një nga figurat kryesore të lëvizjes komuniste shqiptare dhe ndër drejtuesit qendrorë të strukturave politike, shtetërore dhe të sigurisë në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore. Roli i tij u shtri nga organizimi i lëvizjes komuniste dhe drejtimi partiak, te ndërtimi i aparatit shtetëror të sigurisë dhe ushtrimi i pushtetit në vitet e para të regjimit. Ai ishte themelues dhe kryetar i parë i Grupit Komunist të Korçës, ndër grupet që do të kontribuonin në krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare. Mori pjesë në mbledhjen themeluese të Partisë Komuniste Shqiptare dhe, që nga krijimi i saj, ishte anëtar i Byrosë Politike dhe i Komitetit Qendror. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Xoxe u përfshi në veprimtarinë e lëvizjes antifashiste. Në vitet 1941 dhe 1942 u burgos nga autoritetet italiane, ndërsa më 10 korrik 1942 u bë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Në Kongresin e Përmetit, më 24 maj 1944, u gradua gjeneral-leitnant. Me vendosjen e pushtetit komunist, pozicioni i Xoxes u zgjerua ndjeshëm. Në shkurt 1945 u emërua kryetar i Gjykatës së Lartë. Po atë vit mori funksionet e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punëve të Brendshme, ndërsa njëkohësisht drejtoi strukturën e Sigurimit të Shtetit. Në këtë periudhë, ai ishte një nga figurat që mbulonte njëkohësisht nivelet më të larta të pushtetit politik, administrimit shtetëror dhe aparatit të sigurisë. Në vitin 1945 u zgjodh deputet në legjislaturën e parë të Kuvendit Popullor dhe u bë Sekretar Organizativ i Komitetit Qendror të PKSH-së. Këto funksione e vendosën atë në qendër të procesit të organizimit të strukturave të reja të shtetit dhe të konsolidimit të pushtetit politik. Roli i tij në sistemin e drejtësisë së viteve të para të regjimit dokumentohet edhe në Gjyqin Special të vitit 1945, ku Xoxe ishte kryetar i trupit gjykues. Burime arkivore dhe studimore e paraqesin këtë proces si një nga gjyqet e para politike të periudhës së pasluftës. Pozicioni i tij në strukturat drejtuese vazhdoi edhe në vitet pasuese. Në 1948 u emërua ministër i Industrisë dhe Minierave. Për veprimtarinë e tij gjatë periudhës së luftës dhe pas saj, ai u dekorua me titullin “Hero i Popullit” dhe me dekorata të tjera të larta shqiptare. U nderua gjithashtu me dekorata nga vende të tjera të kampit socialist, ndër to Bullgaria, Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik. Në këtë kuptim, karriera e Xoxes përfaqëson një ndërthurje të veçantë të funksionit partiak, shtetëror, ushtarak dhe të sigurisë. Ai nuk ishte vetëm një drejtues politik, por një nga figurat që mori pjesë drejtpërdrejt në ndërtimin dhe drejtimin e institucioneve përmes të cilave regjimi i ri ushtroi pushtetin në vitet e para. Dokumentet e procesit të tij penal të vitit 1949 marrin një rëndësi të veçantë pikërisht për këtë arsye. Në dëshmitë dhe deklarimet e përfshira në dosje shfaqen jo vetëm akuzat ndaj Xoxes, por edhe të dhëna mbi mënyrën e funksionimit të strukturave të sigurisë, arrestimeve, hetimeve dhe përdorimit të mjeteve joligjore në vitet e para të regjimit. Në dokumentacionin e procesit gjenden edhe deklarime të ish-funksionarëve të Sigurimit për rolin e Xoxes në vendimmarrje dhe në drejtimin e veprimtarive të aparatit të sigurisë. Më 28 nëntor 1948, Koçi Xoxe u arrestua. Në vitin 1949 u zhvillua procesi penal ndaj tij dhe bashkëpunëtorëve të tij. Ai u dënua me vdekje dhe u ekzekutua më 11 qershor 1949, në moshën 38-vjeçare. Rëndësia e Koçi Xoxes në historinë e viteve të para të regjimit qëndron në shtrirjen e jashtëzakonshme të funksioneve që ai mbajti njëkohësisht. Nga një prej organizatorëve të lëvizjes komuniste dhe drejtues i saj politik, ai u bë një nga drejtuesit kryesorë të shtetit të ri, duke pasur në varësi ose drejtim institucione të rëndësishme të drejtësisë, rendit dhe sigurisë.

MEDIA #1


Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

MEDIA FAQE #1




Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

MEDIA FAQE #2




Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

MEDIA FAQE #3




Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

MEDIA FAQE #4




Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

MEDIA FAQE #5



Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

MEDIA FAQE #6



Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

INFORMACION

Roli i Koçi Xoxes në shtypjen e rezistencës antikomuniste në Shkodër

FONDI	Hetimor-gyqësor
DOSJA	Nr. 1623.1
LLOJI I DOKUMENTIT	Proceverbal i të pandehurit Vaskë Koleci
DATA E KRIJIMIT	15.1.1949
KRIJUAR NGA	Zyra e Hetuesisë Speciale
FIRMOSUR NGA	Kryetar: Mehmet Shehu, MInistër i Punëve të Brendshme; anëtar: Bexhet Mema; sekretar: Ferhat Matohiti


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Aktakuza


MEDIA FAQE #1



RELACION I SHKURTER MI TOGER HODO HAMIPIN

Aktakuza

MEDIA FAQE #2



Aktakuza

INFORMACION

Aktakuza

Autoret: Komisioni hetimor

FONDI	Hetimor-gjyqësor
DOSJA	Nr. 1623.1
KRIJUAR NGA	Komisioni hetimor- Bedri Spahiu, Gaqo Flloqi, Sotir Qirjaqi
NUMRI I FAQEVE	17
LLOJI I DOKUMENTIT	aktakuzë


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3


Pjesë nga deklarimet e Koçi Xoxes ne proces

MEDIA FAQE #1



Pjesë nga deklarimet e Koçi Xoxes ne proces

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Pjesë nga deklarimet e Koçi Xoxes ne proces

FONDI	Hetimor-gjyqësor
DOSJA	Nr. 1623
STRUKTURA	Komisioni hetues
LLOJI I DOKUMENTIT	Procesverbal
DATA E KRIJIMIT	22.03.1949


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Deklarime të Zoi Themelit mbi Koçi Xoxen

MEDIA FAQE #1



LETËR MI SHKELJE E LIGJEVE NË FLAGRANC.

Mas ngjarjes të 9 shtatorit, që ndodhi në Shkodër 4-5
dit që mundkujtohet mirë, mëthirë nga D.S.SH; në Tiranë. Këtu masi
mdesi utakova me Nesti K, arthi dhe Koçi Xoxe. KY (K) masi më p
pyheti për ngjarjen që ndodhi, dhe pse ndodhi, më tha: Duhet që
patjetër të bëni çarmatimin rëhjësor në popull. Nëkëtë rast unë
ithem se nuk ashtë e letë dhe se populli nuk iderëzon armët kol
llaj, ay ashtë ilidhur ngushtë me armën dhe ashtë e zeqme të bëhe
t çarmatimi. Për Koçi me nervozitet më thotë, duhet patjetër çar
matimi, situatë sasht e qartë dhe zduhet tëketë armë popullsia sta
j shtoj; duhet të kapet patjetër Jup Kazazi dhe të bënk çarmati
min, pushkatono njerëz me influencë dhe patjetër duhet ti arini
këti qëllimi. Mekaq dhe ulargua.

Mëvan mas tre kohësh dit që vajta në Shkodër, mësova se këtë urdhër
jaskishin dhënë edhe edhe organeve të tjera si policisë, këshmo-ë
ra vesht masi në këtë kohë, organet e Policisë filluan ngaj vepër
imi pa asnjë marëveshtje me oganet csig. Kjo shkaktoj që neve t
ta shrojmë ~~xxxxx~~ në Komitet the të kordinojmë veprimet, sideqef
të, uvranë pa gjyq ma se 6-7 veta.


Këtu vlen përtushënuar, se në këtë kohë nuk ubë vetëm në Shkodër
Këtu vlen përtushënuar, se në këtë kohë nuk ubë vetëm në Shkodër
çarmatimi, por në gjithë Shqipërinë. Dhe injëti urdhë jusahtë dhë-
në të gjithëve, ku janë përdorur turturat në masë, dhe janë pushk-
atuar njërëz pagjyqe, duke shkelur ligjet e shtetit në flagrano.
Mesa mam dëgjuar, se nëkëtë kohë ky veprim ashtë bërë pa dallim
si në krainat qëkishin lëftuar kundra okupatorit dhe në njërëz q
që kishin marë pjesë me armë nëdorë në reshtat partisane. ku dhe
shumë ngaj këta janë turturuar poshtërsisht.

Përtë gjita këto veprime, dhe për shkeljen e ligjeve në
flagrano siç uthekaua edhe më sipër ka urdhëruar personalisht
vetë Koçi dhe ky ashtë përgjegjës në radhë të parë.

ZOI THEMELI

Deklarime të Zoi Themelit mbi Koçi Xoxen

MEDIA FAQE #2



dhe duke hipur perubi ligjet e shtetit jep urdher per vrasjen e Hodos
drejtë per së drejti gjyqit.

6)- Ketu poshte po shenoj edhe dy raste te cilat lidhen
me punen trockiste te Koçi Xoxes.-

Me kujtohet se ne vitin 1945-46, na jane derguar
3-4 shkresa te mëryshme te firmosura nga vete Koçi Xoxe. Permbajtja
e ketyre nuk me kujtohet, porse ishin me karakter politik dhe jepshin
udhezime mbi punen e sigurimit.

Per tu theksuar dhe qe ka rendesi eshte se ne fund
te ketyre shkresave shenohej qe: kendoje dhe digje. Tani keto shkresa
kuptohen kjarte se kane qene ne kundershtim me vijen e partise dhe
dgjeshin per te mos mbetur dokumenta me te cilat te faktoheshe puna
trockiste dhe anti parti e ketij.-

Koçi Xoxe i cili i shkruante keto xxxxx xxxxx shkre-
sa duhet ti dije se çfarë ka shkrojtur ne to dhe qellimin e tyre, mba-
si aks asnje kuptim qe te grisen shkresat pa nje qellim.-

7)- Ne vitin 1946 qe data sme kujtohet kemi bere nje
mbledhje ketu ne Tirane ku mernin pjese të gjithë shefat e Sig.Shtetit
dhe qe e kryesonte vete Koçi Xoxe.

Nga fundi i mbledhjes une i them Koçi Xoxes, se
perse neve si kemi vene fotografit e Komandantit ne per zyrat t'ona
dhe te popullarizojme ne popull, kurse ne ju qellevi fotografit e Ti-
tos i kane vene jo vetem ne per zyra dhe dyqane por edhe ne per rruge.
Njekohesishte i propozoj qe eshte mire te behen fotografit e Komanda-
ntit me shumice dhe se me shpejte te viheshin ne per zyra e dyqane,
keshtu qe te popullarizohesh dhe populli te shikoj fytyren e udhehe-
qesit te tije.-

Kete propozim trockisti Koçi e mori si nje gje shum
te vogel dhe pa rendesi, duke pershperitur ne per buze, se mir mir
por aks leter per fotografi dhe pa asnje shpegim e le kete qeshtje
duke folur per gjera te tjera.-

Tani kjo sdo komente, se qellimi i ketij trockisti
ishte, qe e ka penguar popullarizimin e udhehe qesit te popullit shqi-
ptar per te zene vendin e tij.

Tiranë, më 6IV/1949.- DEKLARUESI
(M/KOLONEL(ZOI THEMELI)

INFORMACION

Deklarime të Zoi Themelit mbi Koçi Xoxen

Autoret: Zoi Themeli

FONDI	Hetimor-gjyqësor
DOSJA	Nr. 1623.6
KRIJUAR NGA	Zoi Themeli


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Relacion i shkurtër mbi toger Hodo Habipin


MEDIA FAQE #1



RELACION I SHKURTER MBI TOGER HODO HABIPIN

Relacion i shkurtër mbi toger Hodo Habipin

MEDIA FAQE #2



- 2 -

Ketu eshte per t'u shenuar edhe vepramarrja qe sherbeu qe
toger Hodoja i ka vere pusuetit t'one.
1) Ujat kohes qe ky ka qene ne njohjen e krimineleve ka treguar
se e tjera qe kishin te njejten detyre per aktivitet due ka znou-
ne nje numer te konsiderueshme krimineleshm.
2) Persa dikush eshte treguar mjonje kujdes i mire per mireqenje
te shpetimit nga rreziku qe i ndodhi.
Ky ishte dikushi qe me pare moi njohjet jo korekte me popull
me jo vetem qe s'u muar mjonje mase per t'a mirequr due s'ju vu
mjaft snok prane,por sq me vepar qe duke e pare se eshte gabime nuk
u muar mjonje mase per larguimin e tij me mjonje vend vjetor ku kish-
te kuncesi te zhvoshte te metat qe egzistonin tek Ky due t'a shpetu-
on nga rrezziku/
3) Simues mendimin t'im Hodoja nuk mbrapshte qendrimin kapriçi dhe
qe me vepar vargjen ne lider.
Per kete te lundrat une duke e pare jo se drejte due te laggesme
i lidhur me nevoja ndjenjen se dhuna qe mbajtonej s'ishte i drejte
mesi veç te vjerave Ky Shoc due ushtrise,por nevoja Kish nje nder
tij aspektet masa ka lidhur me kujdes) Me kshtu pergjigjem qe se ve-
shte Ky ushtrise,dhe... se vepar para popullsise nese vepramar.
vdekjen gjyqin drejt, por nuk jam.
Mos dëshiroj qe ju dua nuqus dhe kryesisht gjyqit Kuso Biloca
per gene d'akord due kete e kemi ushtruar ushtrise,por u vepruar kesaj
te urnerohet kuqi Xoxe,due qe s'ka gene e lagjshme per nje ushtrark
Prandaj si per mos kujdesjen per t'a narequr due shpeshur nd-
dhe nga rrezziku dhe per vrajen ne liter te tij perqjegjes kryesor
eht Koçi Xoxe,dhe per kete Ky dukej te japi llogara.

Kolonel
(Koi Dzemali)

INFORMACION

Relacion i shkurtër mbi toger Hodo Habipin

Autoret: Zoi Themeli

FONDI	Hetimor-gjyqësor
DOSJA	Nr. 1623.6
LLOJI I DOKUMENTIT	Relacion
KRIJUAR NGA	Zoi Themeli
DATA E KRIJIMIT	Pa datë

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.